



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 29 Mars 2021

Nr: 184

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË KAVAJË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË G 99, Z. MYNYR TAHIR
BEKSHIU**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ

Me shkresën nr. 4090 prot., datë 08.11.2019, këshilli i bashkisë Kavajë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, për krijimin e vakancës nga këshilltari z. Aldo Ilirjan Duro, propozuar nga subjekti partia Socialiste e Shqipërisë.

Për plotësimin e vakancës në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, bashkia Kavajë, rezulton se lista shumemërore e kandidatëve të Partisë Socialiste të Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Kavajë ka shteruar. Procedura për plotësimin e vakancës në Këshillin e Bashkisë Kavajë, të Partisë Socialiste ka filluar përpara hyrjes në fuqi të ndryshimeve të ligjit nr. 101 datë 23.07.2020 dhe ligjit nr. 118 datë 05.10.20202, në këto kushte referuar nenit 164, pika 4 të Kodit Zgjedhor, në rast se lista e kandidatëve të partisë politike, anëtare të një koalicioni ka shteruar, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë.



Data: 29 Mars 2021

Nr. 184

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G 99, z. Mynyr Tahir Bekshiu

Referuar vendimit të Kolegjit Zgjedhor nr. 32 datë 23.07.2019 “Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Kavajë për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore 2019 si dhe në bazë të nenit 164, pika 4, të Kodit Zgjedhor herësi më i lartë brenda koalicionit i takon subjektit politik Partia G 99.

Në bazë të nenit 164 të Kodit Zgjedhor, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka njoftuar kandidatin me numër rendor 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, me kërkesë për plotësim dokumentacioni si kandidat vijues nga lista shumemërore e Partisë G99, për këshillin e bashkisë Kavajë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit.

Brenda afatit të përcaktuar ligjor asnjë nga kandidatët e mësipërm, nuk depozitoi formularin e vetëdeklarimit brenda afatit ligjor.

Në këto kushte Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, referuar nenit 164, pika 2, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, vijoi procedurën me kandidati vijues nga lista shumemërore e partisë G 99, përkatësisht me kandidatin me numër rendor 13, z. Mynyr Tahir Bekshiu.

Me shkresën nr. 1000 prot., datë 08.02.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Kavajë, z. Mynyr Tahir Bekshiu, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia G 99, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 014 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Mynyr Tahir Bekshiu, në këshillin e bashkisë Kavajë, rezulton se, se nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja "b" dhe pika 3, shkronja "c", të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015", me shkresën nr. 1616 prot., datë 02.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 1617 prot., datë 02.03.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Mynyr Tahir Bekshiu, në këshillin e bashkisë Kavajë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Kavajë, z. Mynyr Tahir Bekshiu.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 2279/1 prot., datë 05.03.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Mynyr Tahir Bekshiu, në këshillin e bashkisë Kavajë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pika 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidati për anëtar z. Mynyr Tahir Bekshiu, në këshillin e bashkisë Kavajë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja "n" e 2, dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".



V E N D O S:

1. Z. Mynyr Tahir Bekshiu, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Kavajë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë G 99, z. Mynyr Tahir Bekshiu.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 29 Mars 2021

Nr. 184

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Kavajë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë G 99, z. Mynyr Tahir Bekshiu